

Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetor për 3/mujorin e parë të vitit 2016.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Në zbatim të Ligjit nr. 147, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues Nr.1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, po paraqesim informacion mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për 3/mujorin e I-rë të vitit 2016, për sistemin e MZHETTS-së.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet dhe funksionet e sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat dhe objektivat e MZHETTS-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të burimeve publike, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, për të realizuar objektivat dhe qëllimet e përcaktuara për vitin 2016.

Fondet buxhetore të planifikuara, menaxhohen në 4 programe buxhetore në të cilat përfshihen 12 institucione buxhetore.

Për sistemin e MZHETTS-së fondet buxhetore, në total janë 2,812,235 mijë lekë, sipas strukturës buxhetore ato paraqiten:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	549,400	137,356	107,285	78
Shpenzime të tjera korrente	429741	147,323	111,947	76
Investime të brendshme	809,094	254,199	27,544	11
Financime të huaja	1.024.000	185,000	73,715	0
TOTALI	2.812,235	724,003	320,491	44

Të analizuar sipas programeve treguesit buxhetor paraqiten:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim” për 3/mujorit I-rë për vitin 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	139,900	34,975	33,114	94
Shpenzime të tjera korrente	154,030	77,062	76,041	99
Investime të brendshme	111,100	22,221	0	0
Financime të huaja	280,000	70,000	3,715	5
TOTALI	685,030	204,258	112,870	55

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 34,975 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 33,114 mijë lekë ose 94 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar ndryshimet në strukturë dhe organikat e tyre.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 154,030 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 77,062 mijë lekë ose 99 %.

Janë konsideruar si shpenzime bazë të funksionimit të veprimtarisë së ministrisë kanë qënë të qëndrueshme, të cilat janë bërë sipas regjistrit të parashikimit publik.

Investimet Publike të Brendshme

Disa nga problematikat e Investimeve Publike për tremujorin e parë:

- **Projekti studimor "Zhvillimi i turizmit të SPA-ve në vendburime termale"**, me vlerën 14 mln lekë. Ka përfunduar përgatitja e termave të referencës dhe përllogaritja e fondit limit dhe janë paraqitur pranë sektorit të prokurimeve. Vonesa e këtij projekti ka ardhur për arsye të natyrës specifike dhe mungesës së një praktike të mëparshme në fushën e studimit të fizibilitetit të SPA-ve, kjo kërkoi edhe një kohë më të gjatë për hartimin e termave të referencës së projektit.
- **Projekti studimor MICE**, me vlerën 15.4 mln lekë, ka përfunduar përgatitja e termave të referencës dhe përllogaritja e fondit limit dhe janë paraqitur pranë sektorit të prokurimeve. Vonesa e këtij projekti, gjithashtu, ka ardhur për arsye të natyrës specifike dhe mungesës së një praktike të mëparshme në fushën e studimit të fizibilitetit, kjo kërkoi edhe një kohë më të gjatë për hartimin e termave të referencës së projektit.
- **Projekti Kombëtar E-turizmi, regjistri kombëtar për menaxhimin e flukseve të lëvizjeve të turizmit (lëvizje brenda dhe jashtë, hyrjet, daljet, statistika)**, me vlerën 10 mln lekë, është konstatuar se për natyrën dhe specifikën e projektit është i pamundur të bëhet, pas bashkëpunimit dhe vlerësimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Për këtë arsye, pritet të rivendoset projekti me një tjetër të rëndësishëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit

- **Fondi për mbështetjen e Turizmit**, me vlerën 21 mln lekë. MZHETTS përgatit dhe mbështet programe për realizimin e projekteve në fushën e turizmit që financohen nga buxheti i ministrisë, që më së shumti, kanë të bëjnë me imazhin, inovacionin, ide dhe njohuri specifike. Është miratuar:
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281 datë 13.4.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”,
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 13.4.2016 “Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”.
 Në pritje të mbledhjes së parë të Komisionit.
- **Projekti “Sistemi informatik për administrimin dhe menaxhimin e të dhenave mbi pronat shtetërore pjese e të cilave do të jenë dhe zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik , praktikat në lidhje me to, krijimi i database për pronat shtetërore, të dhenat e ndryshme në lidhje me to dhe informatizimi i shërbimeve që ofron kjo drejtori”**, me vlerën 25 mln lekë. Vonesa në realizimin e këtij projekti ka ardhur për arsye të ndryshimit të emërimit, janë përfunduar specifikimet teknike nga grupet e punës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) por ende nuk janë miratuar nga ky i fundit.

Për sa më sipër theksojmë se në tremujorin e parë, faktor të tjetër të cilët kanë ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve për Investimet Publike janë; procedurat e zgjatura për miratim të fondeve në zërin “Blerje paisje kompjuterike” nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe procedurat e prokurimit nga Ministria Brëndshme, si dhe nga donatorët e huaj të cilët nuk kanë paraqitur faturat për likuidim pranë Ministrisë.

2. Programi “**Mbështetje për Zhvillim Ekonomik**” për 3/mujorit I-rë për vitin 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:.

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	113,000	28,256	25,664	89
Shpenzime të tjera korrente	126,000	31,600	22,535	71
Investime të brendshme	244,994	81,260	27,200	33
Financime të huaja	670,000	100,000	70,000	70
TOTALI	1,153,994	241,116	155,399	60

Ky Programi zë peshën më të madhe në Ministri, për nga madhësi e fondeve buxhetore, mbi 40 % e fondeve të planifikuara për sistemin e MZHETTS-së dhe përgjegjësia për të realizuar qëllimin dhe objektivat e Politikës së tij, është vlerësuar nga institucionet pjesëmarrëse, si njësi zbatuese, për ti shërbyer krijimit të një klime pozitive, për zhvillimin e biznesit, krijimit të vendeve të reja të punës, reduktimit të informalitetit dhe krijimit të një mjedisi konkurrues, për zhvillimin e investimeve.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 28,256 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 25,664 mijë lekë ose 89 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar ndryshimet në strukturë dhe organikat e tyre.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 31,600 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 22,535 mijë lekë ose 71 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar mospërfundimi i tenderave brenda këtij 3/mujori, nga Ministria e Brendshme.

❖ Investime kapitale të brendshme.

- **Fondi i Konkureshmerise**, me vlerën 28 mln lekë, realizuar 3 mln lekë si dhe miratuar 10 dosje nga të cilat janë disbursuar pjesa e parë (50%) për 5 subjekte, pjesa tjetër është në proces.
- **Fondi Inovacionit**, me vlerën 15 mln lekë, janë paraqitur 3 aplikime, në pritje miratimi i anëtarëve të komisionit nga MZHETTS.
- **Biznese të mbështetura me Fondin Start-up**, me vlerën 10 mln lekë, realizuar 0.5 mln lekë. Janë disbursuar 3 aplikant, pjesa tjetër është në proces për shqyrtimin e 14 dosjeve.
- **Publikim në revistat ekonomike nderkombetare**, me vlerën 36 mln lekë, realizuar plotësisht.
- **Krijimi i funksionaliteteve të Reja në sistemin e QKR për përthithjen automatike të situatës aktuale tatimore (DDPT, NJQV) dhe miratimin e ushtrimit nga AKU**, me vlerën 33.8 mln lekë. Specifikimet teknike janë miratuar nga AKSHI, ka filluar procedura e prokurimit datë 18.04.2016 janë publikuar në sistemin e APP.
- **Krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve për formularet e bashkimit ndërkufitar në sistemin e QKB-së dhe aplikimeve online për bashkimin ndërkufitar dhe shërbimeve të tjera**, me vlerën 49 mln lekë, Vonesa e këtij projekti ka ardhur si rezultat i bashkimit të dy projekteve në një : (i) Krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve për Formularet e Bashkimit Nderkufitar, me vlerën 25 mln lekë, (ii) Krijimi i aplikimeve online për Shërbimin e Bashkimit Nderkufitar të shoqërive tregtare dhe gjithë shërbimeve të tjera, me vlerën 24 mln lekë. Pritet miratimi nga Ministria e Financave, për vazhdimin e procedurave të realizimit të Projektit.

Faktor të cilët kanë ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve për Investimet Publike janë: procedurat e zgjatura për miratim të fondeve në zërin “Blerje paisje kompjuterike” nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe procedurat e prokurimit nga Ministria Brëndshme

❖ Investime kapitale të huaj.

Projekti “Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe sigurimium e Asistencës Teknike për to” nga 100,000 mijë lekë të planifikuara për 3/mujorin e parë të vitit 2016, janë realizuar 70,000 mijë lekë ose 70 %. Për natyrën e veçantë që ka Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve dhe skemës ligjore sipas të cilës funksionon, realizimi faktik i fondeve, apo financimi i Projekteve të SME-ve, është krejtësisht jashtë vendimmarrjes së Programit. Kjo për faktin se, në bazë të Marrëveshjeve ligjore midis Qeverisë Shqiptare dhe Italiane, Programi është krejtësisht i përjashtuar nga vendimmarrja në financimin e Projekteve të SME-ve. Kërkesat e subjekteve për financimin e projekteve nuk paraqiten në PMU, por në Bankë, e cila nga kriteret e larta për të shmangur riskun ka ndikuar në realizimin.

3. Programi “Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infrastuktura e Cilësise e Pronësi industriale” për 3/mujorit I-rë për vitin 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	230,500	57,625	36,296	63
Shpenzime të tjera korrente	57,211	15,661	5,136	32
Investime të brendshme	140,500	46,500	300	0
Financime të huaja	50,000	10,000	0	0
TOTALI	478,211	129,786	41,733	32

Në këtë Program janë realizuar objektivat e identifikuar në politikën e tij, nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të përdorimit të standardeve europiane e ndërkombetare, Adoptimin e standardeve shqiptare, duke promovuar përdorimin e atyre Europiane , mbështetjes së pronësisë industriale, dhe zhvillimit të tregtisë dhe konkurrencës së ndershme, mbrojtjen e markave, patentave dhe regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve, kërkesave për regjistrim për shpikje të depozituar, aplikimeve për ripërtëritje dhe ndryshimeve të kërkuar për marka dhe patenta.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 57,625 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 36,296 mijë lekë ose 63 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar ndryshimet në strukturë dhe organikat e tyre.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 15,661 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 5,136 mijë lekë ose 32 %.

Për sa më sipër, theksojmë se në mosrealizim ka ndikuar planifikimi i shpenzimeve të personelit dhe ato operative, për institucionin e ri, “**Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut**”, i cili fillon veprimtarinë në 3 mujin e II-të të vitit 2016.

Investime kapitale të brendshme,

Faktor të cilët kanë ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve për Investimet Publike janë; procedurat e zgjatura për miratim të fondeve në zërin “Blerje paisje kompjuterike” nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe procedurat e prokurimit nga Ministria Brëndshme.

Për DPM-në Projekti “**Ngritja e Labororit të kohë frekuencës dhe vazhdim i kompletimit të labororit ekzistues të DPM-se , me pajisje edhe instrumenta mates**”, me vlerën 103 mln lekë, informojmë se tenderi është shpallur në dt 29.01.2016, subjekti i vetëm pjesëmarrës është skualifikuar, DPM ka rishpallur sërish tenderin.

4. Programi “Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit” për 3/mujorit I-rë për vitin 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016	Realizimi faktik 3/mujorit I 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	66,000	16,500	12,210	74
Shpenzime të tjera korrente	92,500	23,125	8,234	36
Investime të brendshme	312,500	104,218	44	0.1
Financime të huaja	24,000	5,000	0	0
TOTALI	495,000	148,843	20,488	14

Institucionet që përfshihen në të janë angazhuar në realizimin e objektivave, brënda fushës së përgjegjesisë shtetërore, në sensibilizimin e vizitorëve, organizimin e veprimtarive turistike, promovimin e resurseve turistike lokale, organizime takime me gazetarët e huaj turistikë për mundësinë e bashkëpunimeve si dhe gjetjen e mënyrave më të mira për promovimin e turizmit.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 16,500 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 12,210 mijë lekë ose 74 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar ndryshimet në strukturë dhe organikat e tyre.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 23,125 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 8,234 mijë lekë ose 36 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar mospërfundimi i tenderave brenda këtij 3/mujori, nga Ministria e Brendshme.

Investimet kapitale të brëndshme.

- **Projekti për zbatimin e Brandit Shqiptar "Go Your own Way"**, me vlerën 120 mln lekë. Ka nisur një komunikim me GIZ për të ofruar një asistencë sa më profesionale në hartimin e specifikimeve teknike, duke patur parasysh faktin që është hera e parë që po vihet në zbatim një projekt i tillë.
- **Modeli i zhvillimit të integruar të Turizmit në Rivieren Joniane Shqiptare**, me vlerën 15 mln lekë. Është punuar për pjesën e akteve nënligjore, ku nëpërmjet zyres juridike është dhënë kontributi i kërkuar AKT-së dhe mbajtja e kontakteve me grupet e interesit për të dhënë informacionin e duhur mbi këtë çështje. Në këtë kuadër janë zhvilluar takime edhe me konsulentët e huaj që janë venë në dispozicion nga GIZ.
- **Ngritja e 10 Pikave "InfoPoint"**, me vlerën 15 mln lekë. Janë ngritur grupet e punës për secilen fazë të prokurimit dhe aktualisht po punohet mbi specifikimet teknike dhe nxjerrjen e fondit limit. Duke qenë se janë element teknik të një profili të lartë, grupi i punës ka marrë kohën e duhur që të punoj për nxjerrjen sa më të saktë të këtyre specifikimeve. Puna aktualisht është thuhet në fazën konkluduese të kësaj pike.
- **Sinjalistika e Vijës Bregdetare**, me vlerën 20 mln lekë, janë përgatitur Termat e Referencës dhe janë shpallur në Agjencinë e Prokurimit Publik.
- **Inovacioni Teknologjik**, me vlerën 30 mln lekë, janë në proces për përgatitjen e Termave të Referencës.
- **Krijimi i nfrastrukturës turistike midis zonave malore dhe bregdetare**, me vlerën 20 mln lekë, janë përgatitur Termat e Referencës po identifikohen në terren zonat e ndërhyrjes.

Gjithashtu në përputhje me shkresë të Ministrisë së Financave me të cilën është dërguar limiti i fondit të veçantë, përdorimi i tij është bërë sipas kritereve të përcaktuara në VKM Nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” Fondi i veçantë për 3/mujorin e parë të vitit 2016 është përdorur në 3 raste me një vlerë 155,000 lekë.

Vlen të theksohet se përqëndrimi i Fondit të Veçantë në këtë mënyrë ka bërë që të kemi një përdorim më efektiv të tij, për sistemin e MZHETS-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.